



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.129/2017

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: rafet Haxhaj kryesues, Adnan Konushevci dhe Faton Ademi anëtarë, si dhe me pjesmarrjen e zyrtarit të lart ligjor Kudret Hasani, duke vendsur përkitazi me ankesën e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), paraqitur kundër Koalicionit PDK-AAK-NISMA, për shkak të vendosjes së posterave në drunj të qytetit, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, në seancën e panelit të mbajtur me 09.06.2017, mori këtë:

## V E N D I M

**Pranohet** si e bazuar ankesa e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), ashtu që Koalicionit PDK-AAK-NISMA, i shqiptohet dënim i më gjobë në vlerë prej 3,200.00 (tremijë e dyqind) euro, të cilën detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita e pranimit të këtij vendimi **nën kërcënim të përmbarimit**.

## A r s y e t i m

Me datën 07.06.2017, PZAP-i ka pranuar një ankesë nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV) qendra në Podujevë me të cilën pretendon se me datën 06.06.2017 diku rreth orës 16:33 aktivisti Blerim Maqastena ka vërejtur se në rrugën Zahir Pajaziti në Podujevë posteri i Kadri Kastratit dhe Naim Fetahut kandidat per deputet nga koalicioni PDK-AAK-NISMA ishte i ngjitur drunjë të qytetit. Me këtë rast parashtruesi i ankesës thekson se është bërë shkelje e dispozitës së Nenit 4parografi 1 pika b) i Rregulles Zgjedhore 11/2013 dhe 3.4 të Rregulles Zgjedhore 13/2014 të KQZ-së.

Parashtruesi i ankesës si provë ka bashkangjitur fotografi të printuara nga vendi i ngjarjes në cilësi të provës materiale.

Në përgjigje në ankesë të datës 08.06.2017, koalicioni PDK-AAK-NISMA, thekson se shkelja nuk është e qëllimshme dhe se kjo është bërë nga aktivistët e painformuar mirë me rregullat zgjedhore, dhe se koalicioni në fjalë ka ndërruar të gjitha masat e duhura për ta përmisuar shkeljen. Si dëshmi ka bashkangjitur fotografi me të cilat dëshmohet largimi i posterit nga vendi ku ka qenë i vendosur ai.

Paneli, pasi që shqyrtoj ankesën vlerësoi se:

### Ankesa është e bazuar

Nga fotografitë e ofruara si provë e cila gjendet në shkresat e lëndës shihet qartë se posteri i kandidateve për deputet nga Koalicioni PDK-AAK-NISMA është i vendosur në drunjë të qytetit, veprime këto që janë në kundërshtim me nenin 33 pika b) të LZP-së e cila

përcakton: “*Veprimet e ndaluara nga ana e subjekteve politike gjatë fushatës zgjedhore që ndalon vendosjen e pllakateve, posterave dhe njoftimeve në hapsira apo në rrugë publike.*

Duke u nisur nga arsyet e theksuara me lartë, Paneli konstaton se nga provat e ofruara shihet qartë se nga ana e koalicionit PDK-AAK-NISMA, është shkelur nen 33 pika (b) të LZP-së, pasi që posteri i kandidateve për deputet nga koalicioni PDK-AAK-NISMA, është i vendosur në drunjë të qytetit.

Paneli me rastin e vendosjes se gjobës, ka marrë parasysh rrethanat si në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Nëse subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, konsiderohet se kanë qenë të njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës;
- Nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë si dhe
- Shumën e fondevë të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura më fushatën zgjedhore.

Paneli, mori parasysh të gjitha rrethanat në rastin konkret ngase subjektet politike të koalicionit PDK-AAK-NISMA, kanë marrë pjesë edhe në zgjedhjet e kaluara që do të thot se janë të njoftuar me rregullat zgjedhore, dhe se përkundër këtij fakti posteri i kandidateve per deputet nga ky koalicion është i vendosur në drunj të qytetit ku koalicioni në fjalë ka bërë disa herë përsëritjen e të njëjtës shkelje në këto zgjedhje. Poashtu si rrethanë Paneli mori edhe faktin se Koalicionit në fjalë ia dha mundësinë për tu përgjigjur ashtu që në përgjigjen e pranuar nga ana e tyre shihet qartë se brenda afatit të caktuar kanë ndërrmar veprime për të bërë përmisimin e shkeljes ashtu që kanë tërhequr posterin nga vendi i palejuar, i cili veprim ka ndikuar në lartësin e gjobës së shqiptuar në dispozitiv të këtij vendimi.

Lidhur me kërkesën e parashtruar nga subjektit politik LVV, e datës 09.06.2017, për tërheqjen e ankesës Anr.129/2017, të datës 07.06.2017, e parashtruar ndaj koalicionit PDK-AAK-NISMA, paneli vlerëson se vazhdimi i procedimit është ne interesin e publikut dhe se në këtë rast tërheqja e njërsës prej palëve të interesuara nuk sjell ndërprerjen e procedimit administrativ. Në nen 54 par.1 të Ligjit për Procedurën Administratave është parashikuar që “*Tërheqja e njërsës prej palëve të interesuara nuk sjell ndërprerjen e procedimit administrativ në qoftë se organi kompetent i administratës publike gjykon se vazhdimi i procedimit është në interesin e publikut ose në interesin ligjor të palëve të tjera në procedim*”. Paneli nuk e bëri lejimin e tërheqjes së ankesës sepse ka vlerëuar se veprimi i koalicionit PDK-AAK-NISMA, ka cenuara interesin e publikut kjo aq më tepër kur kërkesës nuk iu ka shoqëruar asnjë provë në bazë të cilave do të dëshmohej se është bërë riparimi i shkeljes në teren, duke i tërhequr posterat nga vendi i palejuar, i cili veprim ka ndikuar në lartësinë e gjobës së shqiptuar si në dispozitiv të këtij vendimi.

Andaj, duke u nisur nga arsyet e theksuara me lart, e në kuptim të nenit 32 par.2, nenit 118 par.1 dhe nenit 120 par.1 pika (c) të LZP-së, lidhur me nenin 51.4 të LPA-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashresa**

Anr.129/2017 më datën 09.06.2017.

**Kryesuesi i Panelit  
Rafet Haxhaj**

**Këshillë juridike:** Kundër këtij vendimi nuk  
lejohet ankesa konform nenit 118.4 të LZP-së.

